

KONTRATE

SHITBLERJE AKSIONESH

Në Tiranë, sot më datë 11 Janar, 2024, ditën e enjte, për redaktimin e kësaj kontrate shitblerje aksionesh, u paraqitën personalisht palët :

SHITËSI: Shoqëria “RUBICON” SHA me NIPT M02129014T, me seli në Tiranë, Rruga “Papa Gjon Pali II”, Pll. 11/1, Ap 1, Tiranë Shqipëri, përfaqësuar nga Administratori **Z. Eno Kotmilo**, lindur më 13.08.1981 në Tiranë, i identifikuar nëpërmjet Letërnjoftimit ID me Nr. Personal: **I10813057F**, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, (këtu e më poshtë referuar si: “Shitësi”),

DHE

BLERËSI: Shoqëria “Image & Communications Development” SHPK, me Nipt L01511027P, me adresë në Tiranë, Njësia Bashkiake nr.5, Rruga “Donika Kastrioti”, Pallati Teknoprojekt, Apartamentet 5/1 dhe 5/6, **përfaqësuar nga ortakut i vetëm dhe administratori Z. Igli Gjelishti**, i biri i Ilir dhe Zamira, shtetas shqiptar, lindur në Lushnjë, më datë 14.07.1984, banues në Tiranë, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, i identifikuar nëpërmjet Letërnjoftimit ID me Nr. Personal: **I40714061P**.

Baza Ligjore:

- Neni 705 e në vijim i Kodit Civil;
- Ligji nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” i ndryshuar;
- Statuti i shoqërisë “Rubicon” SHA;
- Vendimi i Asamblesë së Shoqërisë “Rubicon” SHA nr. 72/1, datë 08/12/2023;
- Njoftimi i refuzimit të nënshkrimit nga bashkëaksionerët e shoqërisë “Rubicon” SHA.
- Vendimi i Ortakut të vetëm të shoqërisë “Image & Communications Development” SHPK nr. 2/2024 datë 04/01/2024 për nënshkrimin/pagimin dhe blerjen e aksioneve të emetuara nga shoqëria “Rubicon” SHA;


Objekti i Kontratës: Shitje e aksioneve të emetuara nga shoqëria “RUBICON” SHA, me NIPT M02129014T.

1. Shitësi, Shoqëria “RUBICON” SHA, në vlerësim të propozimit financiar të ardhur nga shoqëria "Image & Communications Development" shpk, ka marrë vendimin e Asamblesë nr. 72/1, datë 08.12.2023, të publikuar sipas legjislacionit në fuqi në

Qendrën Kombëtare të Biznesit, sipas të cilit ka emetuar 105.034.657 (njëqind e pesë milionë e tridhjetë e katër mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë e shtatë) aksione të reja të pagueshme në para, me vlerë totale 130.885.000 (njëqind e tridhjetë milion e tetëqind e tetëdhjetë e pesë mijë) Lekë.

2. Blerësi, **Shoqëria “Image & Communications Development” SHPK**, me Nipt **L01511027P**, me adresë në Tiranë, Njësia Bashkiake nr.5, Rruga “Donika Kastrioti”, Pallati Teknoprojekt, Apartamentet 5/1 dhe 5/6, **përfaqësuar nga ortaku i vetëm dhe administratori Z. Igli Gjelishti**, në bazë dhe për zbatim të vendimit të ortakut të vetëm nr. 2/2024, datë 04/01/2024, ka shprehur interes dhe ëshë dakord për blerjen e 105.034.657 (njëqind e pesë milionë e tridhjetë e katër mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë e shtatë) aksione të reja të pagueshme në para, me vlerë totale 130.885.000 (njëqind e tridhjetë milion e tetëqind e tetëdhjetë e pesë mijë) Lekë. Blerësi është njohur paraprakisht me paqsyrat financiare te shitësit dhe sistemet e përdorura prej tij dhe nuk ka pretendime në lidhje me këto pasqyra dhe nuk mund të pretendoje ndryshime në kontrate mbi baze të rezultateve të kompanisë.
3. Shitësi, deklaron se ka rënë dakort me blerësin për shitjen tek ky i fundit të 105.034.657 (njëqind e pesë milionë e tridhjetë e katër mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë e shtatë) aksione të reja të pagueshme në para, me vlerë totale 130.885.000 (njëqind e tridhjetë milion e tetëqind e tetëdhjetë e pesë mijë) Lekë, pagesë e cila likujdohet sipas pikës 4 të kësaj kontrate.
4. Pagesat fillojnë të kryhen nga Blerësi në llogarinë e shoqërisë “Rubicon” SHA menjëherë me nënshkrimin e kësaj kontrate sipas planit të pagesave të përcaktuar në Aneksin 1 të vendimit nr. 72/1, datë 08/12/2023 të Asamblesë së Shoqërisë “Rubicon” SHA, duke filluar pagesa e muajit 1 nga muaji Janar 2024 e në vijim deri në përmbylljen e plotë të pagesave, siç përcaktohet edhe më poshtë:

Muaji	Vlera në lekë
Muaji 1	3 165 000
Muaji 2	3 165 000
Muaji 3	13 165 000
Muaji 4	3 165 000
Muaji 5	3 165 000
Muaji 6	3 165 000
Muaji 7	3 165 000
Muaji 8	3 165 000
Muaji 9	3 165 000
Muaji 10	2 800 000
Muaji 11	2 800 000
Muaji 12	12 800 000
Muaji 13	2 800 000
Muaji 14	2 800 000
Muaji 15	2 800 000



Muaji 16	2 500 000
Muaji 17	2 500 000
Muaji 18	2 500 000
Muaji 19	2 500 000
Muaji 20	2 500 000
Muaji 21	2 500 000
Muaji 22	2 200 000
Muaji 23	2 200 000
Muaji 24	12 200 000
Muaji 25	2 200 000
Muaji 26	2 200 000
Muaji 27	2 200 000
Muaji 28	2 000 000
Muaji 29	2 000 000
Muaji 30	2 000 000
Muaji 31	2 000 000
Muaji 32	2 000 000
Muaji 33	2 000 000
Muaji 34	1 800 000
Muaji 35	1 800 000
Muaji 36	11 800 000

Shoqëria “Image & Communications Development” SHPK mund të kryejë pagesa të pjeshme ose të përmbyllë pagesën e plotë edhe përpara afateve të sipërpërmendura.

5. Me këtë kontratë shitje, shitësi i kalon blerësit pronësinë mbi 105.034.657 (njëqind e pesë milionë e tridhjetë e katër mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë e shtatë) aksioneve të emetuara rishtazi e që përfaqësojnë 48.12% të kapitalit në shoqërinë “Rubicon” SHA, dhe blerësi **Shoqëria “Image & Communications Development” SHPK**, me **Nipt L01511027P** bëhet menjëherë pronar i këtyre aksioneve në shoqërinë “Rubicon” SHA, duke ushtruar të gjitha të drejtat që mbartin këto aksione.
6. Nëse shoqëria **“Image & Communications Development” SHPK** nuk kryen rregullisht pagesën sipas planit të parashikuar në pikën 4 të kësaj kontrate me një vonesë më të madhe se 45 ditë për secilën pagesë, ajo humbet ë pjesën e aksioneve që i përket pagesës përkatëse të pakryer, proporcionalisht, duke pasur si pasojë ligjore anulimin e atyre aksioneve për të cilat nuk është kryer pagesa përkatëse, plus një penalitet prej:
 - a. 25% të aksioneve që i korrespondojnë shumës së painvestuar/pagesës së pakryer nëse ajo është më e madhe se 70% e vlerës së kontratës.
 - b. 15% të aksioneve që i korrespondojnë shumës së painvestuar/pagesës së pakryer nëse ajo është më e midis se 30% dhe 70% të vlerës së kontratës.

c. **5% të aksioneve që i korrespondojnë shumës së painvestuar/pagesës së pakryer nëse ajo është më e vogël se 30% e vlerës së kontratës.**

7. Pjesa e papaguar e aksioneve, nuk mund të tjetërsohet, shitet, dhurohet apo vendoset si kolateral nga shoqëria "Image & Communications Development" SHPK.
8. Për dividendin që mund të shpërndajë shoqëria "Rubicon" SHA deri në vlerën 104,000,000 (njëqind e katër milionë) lekë ose deri në vitin financiar 2027, cilado që vjen e para, shoqëria "Image & Communications Development" SHPK në cilësinë e aksionarit të shoqërisë "Rubicon" SHA heq dorë nga pjesa e dividendit që i përket aksioneve që përfaqësojnë 48.12% të kapitalit të shoqërisë apo aksioneve të emetuara rishtazi dhe të nënshkruara/paguara nga shoqëria "Image & Communications Development" SHPK sipas kësaj kontrate.

Çdo lloj marrëveshje tjetër mbi këtë kontratë vendoset nga palët me aneks kontrate dhe vetëm me shkrim, pas miratimit me shumicë të kualifikuar (me tre te katërtat e votave) nga asambleja e ortakëve të Rubicon sh.a.

Kontrata u hartua në 4 (katër) kopje të barasvlefshme, nga të cilat dy kopje i merr shitësi, një kopje e merr blerësi dhe një kopje depozitohet në QKR.

Kontrata pasi u hartua dhe u lexua nga palët dhe si u gjet në përputhje me vullnetin e tyre të lirë dhe të plotë, u nënshkrua prej tyre pa vërejtje.

PALËT

SHITËSI

Shoqëria "Rubicon" SHA

**Administratori
Z. Eno KOTMILO**



BLERËSI

**Shoqëria "Image & Communications
Development" SHPK**

**Administratori
Z. Igli GJELISHTI**

